



Pranuar / Dorezuar Prilbjen/Prilato Received / Delivery	25.05.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHICK	3030/2022		112



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.356/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Shaqiri-Mehmeti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.356/2022 të datës 12.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit/Institucioni i Avokatit të Popullit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 25.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ lidhur me ankesën A.nr.356/2022 të datës 12.04.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi në datë 12.04.2022 ka parashtruar ankesë më numër protokolli 2024/2022 të regjistruar më numër A.nr.356/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit të Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me njohjen e përvojës së punës sipas deklaratës nën betim të noterizuar me nr.rendor 49.31/2015 dhe me nr.rendor 1770/2015, duke kërkuar që Këshilli këto dokumente ti përfshij në vlerësimin e përvojës së punës deri me datë 31.05.2015 dhe të nxjerrë vendim të ri për përvojën e punës së ankuesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 15.04.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit. Këshilli më datë 29.04.2022 ka pranuar vetëm përgjigjen me sqarimin së Institucioni i Avokatit të Popullit me Rregulloren nr.02/2022 për Disiplinën dhe Ankesat e të Punësuarve në Institucionin e Avokatit të Popullit në rast të kundërshtimit të vendimeve të Komisionit të Ankesave mund iniciojnë procedurë pranë gjykatës kompetente.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2024/2022 të datës 12.04.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 06/29 të datës 15.05.2015 të Qeverisë së Kosovës; Shkresën e datës 08.06.2012 nga Ministria e Administratës Publike; Shkresën për caktimin e grupit punues për vlerësimin dhe pranimin e dokumentet të përvojës së punës datë 21.05.2015; Procesverbali e grupit punues lidhur me vlerësimin e dokumenteve të përvojës së punës me Nr. 123/2015 i datës 25.05.2015, Nr. 124/2015 i datës 08.07.2015; Akt Noterial me Nr. rendor 1170/2015; Procesverbalin me numër 142/2015 të datës 08.07.2015; Deklaratën nen Betim me numër rendor 4931/2015; Deklaratën nen Betim të datës 14.07.2015; Vendimin me Nr. 181/2019 i datës 03.09.2019 nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Institucionin e Avokatit të Popullit; Vendimin me Nr. 67/2019 të datës 04.11.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit; Vendimin me Nr. 257/2019 i datës 12.11.2019 i Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Institucionin e Avokatit të Popullit; Vendimin me Nr. 10/2020 të datës 23.10.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit; Emalin e datës 07.02.2020; Emalin e datës 23.01.2020; Vendimin A.nr.853/2021 të datës 24.01.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje ne anekese me numër të protokollit 2178/2022 të datës 15.04.2022; Përgjigjen e institucionit me numër të protokollit 2515/2022 të datës 29.04.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi së janë përmbushur kushtet ligjore për përfundim të procedimit administrativ të iniciuar me ankesën A.nr.356/2022 të datës 12.04.2022, **SEPSE**:

Ankuesi [redacted] i punësuar në Institucionin e Avokatit të Popullit, në pozitën e punës *Drejtor i Departamentit të Administratës*, me datë 12.11.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit, kundër vendimit me numër protokollit 257/2019 të datës 12.11.2019 të Burimeve Njerëzore, për mos njohjen e përvojës së punës, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr.06/29 të datës 15.05.2015.

Me teje nga vlerësimi i shkresave të lëndës rezulton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit me Vendimin me numër protokollit 10/2020 të datës 23.01.2020 ka aprovuar ankesën e nëpunësit civil [redacted] dhe ka obliguar Divizionin e Burimeve Njerëzore të IAP, që brenda 15 ditësh në pajtim me Vendimin e KZKA-së të IAP Nr.67/2019 të datës 04.11.2019, te trajtoj dokumentet noteriale të prezantuara nga ankuesi si dëshmi e përvojës së punës, në përputhje me nenin 3 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-010 për Noterinë.

Ankuesi pas heshtjes së Zyrës së Burimeve Njerëzore, më datë 21.02.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 409/2020, për mos zbatim të Vendimit me Nr.10/2020 të datë 23.01.2020 të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me njohjen e përvojës së punës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me Vendimin me numër A.nr.853/2022 të datës 24.01.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit [redacted] dhe ka lenë në fuqi Vendimin me numër protokollit 10/2020 të datës 23.01.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kolegji duke u bazuar në rrethanat si me lartë, vlerëson se objekti i ankesës A.nr.356/2022 i datës 12.04.2022 është i njëjtë me objektin e ankesës së ankuesit A.nr.853/2022 të datës 21.02.2020, për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me datë 24.01.2022 përmes Vendimit A.nr.853/2022, rrjedhimisht objekti i të dy ankesave bazohet në të njëjtën gjendje faktike dhe juridike, e që në rastin konkret është njohja e përvojës së punës nga ana e organit të punësimit-IAP sipas dokumenteve noteriale, kështu që, nisur nga ky konstatim dhe në kuptim të dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktikë.*, Kolegji konstatoi se janë përmbushur kushtet ligjore që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.356/2022 të datës 12.04.2022 të parashtruar nga ankuesi

Siç u tha më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridikë:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda më numër A.nr.356/2022

Ilire Mehmeti- Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Avokatit të Popullit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Institucionin e Avokatit të Popullit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

